



Në mbështetje të nenit 64.2 pika (a) dhe (b), neneve 54, 55, 58 dhe nenit 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe neneve 19, 20 dhe 29.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovë (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

## **RREGULLORE NR. 08/2023 VËZHGUESIT E ZGJEDHJEVE**

### **Neni 1 Fushëveprimi**

Kjo Rregullore përcakton procedurën për aplikim dhe akreditim të organizatave, vëzhguesve, mediave, si dhe obligimet e organizatave të akredituara dhe vëzhguesve të tyre.

### **Neni 2 Akreditimi i organizatave dhe i vëzhguesve të tyre**

1. Akreditimi i vëzhguesve për zgjedhje në emër të ndonjë organizate për vëzhgimin e zgjedhjeve duhet të dorëzojnë kërkesë në KQZ, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para ditës së zgjedhjeve.
2. Organizatat që aplikojnë për akreditim për vëzhgim të zgjedhjeve duhet të dorëzojnë kërkesë në KQZ, jo më vonë se njëzet e pesë (25) ditë para ditës së zgjedhjeve.
3. Organizatat që aplikojnë për akreditim për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve duhet të dorëzojnë kërkesën në KQZ, jo më vonë se njëzet (20) ditë para ditës së zgjedhjeve.
4. Organizatat apo individët në emër të ndonjë organizate që aplikojnë për akreditim, duhet të plotësojnë dokumentacionin si në vijim:
  - 4.1. Formularin e akreditimit të vëzhguesit - shtojca I, që është i bashkangjitur këtu;
  - 4.2. listën e vëzhguesve në formën - shtojca II, e bashkangjitur këtu,që përmban:
    - 4.2.1. Emrin, mbiemrin, datën e lindjes, adresën, numrin personal dhe numrin e telefonit për kontaktim për secilin vëzhgues, në formën elektronike dhe kopje të shtypur të nënshkruar nga përfaqësuesi i organizatës.

5. Zyra për regjistrimin e partive politike dhe certifikim (Zyra), duhet t'i verifikojë dokumentet e dorëzuara nga organizata apo individët në emër të organizatës për akreditim.
  - 5.1. Zyra i dorëzon ato në KQZ me rekomandimin për akreditim, jo më vonë se katër (4) ditë pas parashtrimit të tyre, nëse dokumentet janë të plota dhe të nënshkruara si duhet;
  - 5.2. brenda të njëjtit afat ia kthen dokumentet aplikuesit për korrigjim, nëse konstaton se kërkesa për akreditim nuk është e plotë ose është e pasaktë, me njoftimin se çka duhet të plotësohet ose të korrigjohet.
6. Organizata apo individët që kërkojnë të akreditohen në emër të organizatës, dokumentet për akreditim të dorëzuara të së cilës janë kthyer si jo të plota ose të pasakta si në paragrafin 3 të këtij neni, duhet t'i bëjë korrigjimet e vëna në dukje dhe plotësimet në kërkesë dhe t'i ridorëzoje ato dokumente tek Zyra brenda tri (3) ditëve nga njoftimi.
7. Brenda tri (3) ditëve nga marrja e rekomandimit për akreditim nga Zyra, KQZ duhet të vendosë që:
  - 7.1. Ta akreditojë organizatën dhe listën e saj të vëzhguesve, apo të akreditojë dhe të certifikojë individin në emër të një organizate;
  - 7.2. t'ia refuzojë kërkesën për akreditim dhe ta njoftojë me shkrim organizatën përkatëse apo individin përkatës në emër të një organizate, duke i dhënë shpjegime për vendimin e vet dhe duke e informuar parashtruesin e kërkesës për të drejtën e ankimit ndaj atij vendimi në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP).
8. Kërkesa duhet të aprovohet ose të refuzohet jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas dorëzimit dhe pranimit të dokumentacionit të plotë dhe të plotësuar.
9. Zyra duhet ta njoftojë organizatën ose individin që ka kërkuar të akreditohet në emër të një organizate se KQZ e ka akredituar atë, dhe se i ka akredituar vëzhguesit e saj dhe t'ia sigurojë organizatës së akredituar apo individit të akredituar në emër të një organizate, vendimin e akreditimit dhe distinktivët e veçantë për të gjithë vëzhguesit.

### **Neni 3**

#### **Obligimet e organizatave të akredituara dhe të vëzhguesve të tyre, apo individëve që vëzhgojnë në emër të një organizate**

1. Organizata e akredituar është përgjegjëse dhe duhet të sigurojë që vëzhguesit e saj janë plotësisht të informuar me të drejtat dhe obligimet si dhe me procesin zgjedhor.
2. Organizata e akredituar është përgjegjëse për sjelljen individuale të vëzhguesve të saj.

Nëse organizata e akredituar konstaton se ndonjëri nga vëzhguesit e saj, apo një individ që vëzhgon në emër të një organizate ka shkelur kodin e sjelljes për vëzhgues, ajo mund ta anulojë distinktivin e atij vëzhguesi dhe t'ia dorëzojë atë KQZ në mënyrë që atij/asaj t'i anulohet akreditimi si vëzhgues.

3. KQZ në çdo kohë mund ta anulojë akreditimin e vëzhguesit që cenon LZP, Rregulloret e KQZ, urdhëresat ose procedurat administrative lidhur me procesin zgjedhor.
4. Pas njoftimit të refuzimit nga Zyra për akreditim të vëzhguesve, subjekti të cilit i është refuzuar kërkesa për akreditim, ka të drejtë ankese në PZAP, 24 orë prej momentit të marrjes së njoftimit.

#### **Neni 4**

#### **Akreditimi dhe roli i mediave**

1. Stafii i mediave të shkruara apo atyre elektronike (shtëpive mediatike) të cilët duan të hyjnë në qendër të votimit (QV), në vendvotim (VV) apo në qendrën për numërim dhe rezultate (QNR) në ditën e zgjedhjeve apo gjatë numërimit, duhet të jenë të akredituara nga KQZ.
2. Afati për aplikim për akreditim i mediave, është më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve.
3. Lista duhet të përmbajë të dhënat dhe dokumentet si më poshtë:
  - 3.1. Emrin e shtëpisë mediatike;
  - 3.2. emrin dhe mbiemrin e personit;
  - 3.3. një kopje të dokumentit identifikues të mediave.
4. Pas njoftimit, Zyra brenda pesë (5) ditësh duhet të lëshojë distinktivët për akreditim të mediave. Distinktivi i akreditimit të mediave është i vlefshëm së bashku me dokumentin identifikues të mediave.
5. Bartësi i distinktivit për media do të ketë të drejtë, sipas nenit 56.3 të LZP:
  - 5.1. të hyjë në QV, VV dhe QNR, si dhe në objektet tjera të KQZ dhe Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), që janë të hapura për publikun dhe mediat. Bartësi distinktivit konsiderohet si vëzhgues;
  - 5.2. të marrë pamje me kamerë dhe fotografi;
6. Aktiviteti i stafit të mediave nuk duhet të cenojë integritetin e procesit zgjedhor, heshtjen zgjedhore, privatësinë dhe fshehtësinë e votës.

7. KQZ në çdo kohë mund të tërheqë akreditimin e stafit të një medie, në rast të shkeljes së dispozitave të legjislacionit zgjedhor.

#### **Neni 5**

#### **Vëzhguesit e zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve**

1. Vëzhguesit e akredituar para ditës së zgjedhjeve të raundit të parë, mund të vëzhgojnë raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave.
2. Përfaqësuesit e subjekteve politike të certifikuara, organizatave jo qeveritare (OJQ), organizatave qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatave ndërkombëtare që janë të specializuara dhe të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, vendeve të huaja apo mediave, mund të aplikojnë në KQZ për t'u akredituar për vëzhgimin e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, ose nëse tashmë janë të akredituar si organizatë e vëzhguesve, mund të dorëzojnë kërkesën për akreditim të vëzhguesve shtesë, jo më vonë se pesë (5) ditë para ditës së zgjedhjeve.

#### **Neni 6**

#### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla zgjedhore nr.07/2013 vëzhguesit e zgjedhjeve.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë shtojcat:

shtojca I - Formulari i akreditimit të vëzhguesve;

shtojca II - Lista e vëzhguesve;

#### **Neni 7**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

**Kryesues**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---

**Kreshnik Radoniqi**